



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

**RAPORTI VJETOR I KONTROLLIT TË TREGUT ME MALLRA
STRATEGJIKE**

Prill 2018 – Prill 2019

Prishtinë, Prill 2019

Përmbajtja:

I - PJESA E PARË.....	3
HYRJE.....	3
Qëllimi i kontrollit strategjik të tregut	3
II. PJESA E DYTË	3
Legjislacioni.....	3
Aktet nënligjore, të cilat janë duke u zbatuar.....	4
Zbatimi i ligjeve të tjera në funksion të kontrollit të tregtisë me mallra strategjike	4
III. PJESA E TRETË	5
Institucionet shtetërore përgjegjëse.....	5
IV. PJESA E KATËRT.....	7
Kontrolli dhe licencimi	7
V. PJESA E PESTË	9
Zhvillimet.....	9
Aktivitetet e zhvilluara në periudhën Prill 2018—Prill 2019	9
Aktivitetet tjera	12
Vendimet tjera;.....	13
Të Tjera;.....	14
VI. PJESA E GJASHTË	15
Bashkëpunimet.....	15
Bashkëpunimi me Industrinë	15
VII. PJESA E SHTATË.....	20
Sanksionet.....	20
VIII. PJESA E TETË	21
Sfidat dhe Rekomandimet.....	21

I - PJESA E PARË

HYRJE

Kontrolli i tregtisë me mallra strategjike, shërbime të ndërlidhura mbështet synimet e Republikës së Kosovës, për të marrë pjesë në të gjitha iniciativat e përbashkëta rajonale dhe ndërkombëtare të mbikëqyrjes së transferimeve ndërkombëtare të mallrave strategjike.

Kontrollimi strategjik i tregut në Republikën e Kosovës, zbatohet përmes rregullativës ligjore dhe strukturave institucionale qeveritare në dikastere të ndryshme.

Qëllimi i kontrollit strategjik të tregut

Qëllimi kryesor i krijimit të sistemit të kontrollit të tregtisë me mallra strategjike është mbrojtja e interesave të sigurisë kombëtare dhe përmbushja e angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës për mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë dhe mallrave tjera strategjike të shfrytëzuara për qëllime ushtarake dhe ti kontribuojë përpjekjeve ndërkombëtare dhe rajonale për rregullimin e tregtisë me mallra strategjike, kufizimin e transferimeve të armëve konvencionale, si dhe marrja e masave për shmangien e përdorimit të tyre për qëllime terroriste dhe të kundërligjshme.

II. PJESA E DYTË

Legjislacioni

Ligji nr. 04/L198 për tregtinë me mallra strategjike

Në qershor të vitit 2013, është aprovuar nga parlamenti dhe në gusht është shpallur në Gazetën Zyrtare, Ligji nr. 04/L-198, për Tregtinë me Mallra Strategjike.

Ky ligj rregullon eksportin, importin, transitin, trans-ngarkimin, ri-eksportin dhe ri-transferimin e mallrave strategjike, ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura, si dhe kontrollin, mbikëqyrjen, të drejtat dhe detyrimet e palëve që marrin pjesë në aktivitet e biznesit nga kjo fushë.

Ky ligj zbatohet ndaj:

- secilit person fizik ose juridik në territorin e Republikës së Kosovës, duke përfshirë të gjitha zonat tregtare, zonat e lira doganore, dhe hapësirën ajrore;
- secilit shtetas të Republikës së Kosovës, brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës;
- secilit person juridik i cili në Republikën e Kosovë e ka të regjistruar zyrën, selinë ose veprimtarinë e përhershme të biznesit si dhe zyrat përfaqësuese ose subsidiare të personit në vendin e huaj;
- secilit person të huaj, i cili gjendet jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe që operon në emër ose nën kontrollin e personit nga Republika e Kosovës.

Aktet nënligjore, të cilat janë duke u zbatuar

- Udhëzimi Administrativ nr.14/2013 për regjistrimin, licencimin, dhe zbatimin e procedurave administrative,
- Udhëzimi Administrativ nr.02/2016 për formularin e regjistrimit, licencimit, të klasifikimit dhe certifikimit të tregtisë së mallrave strategjike dhe shërbimeve të ndërlidhura,
- Rregullorja nr. 35/2013 për funksionimin e punës së Komisionit për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike,

Listat e mallrave strategjike, të cilat përditësohen çdo fundvit konform listave të BE-së:

- Lista e mallrave për përdorim ushtarak, të cilat i nënshtrohen kontrollit shtetëror të importit dhe eksportit.
- Lista e mallrave me përdorim të dyfishtë, të cilat i nënshtrohen kontrollit të importit dhe eksportit.

Zbatimi i ligjeve të tjera në funksion të kontrollit të tregtisë me mallra strategjike

- Ligji për përdorimin civil të eksplozivëve nr. 04/L-022
- Ligji për plehrat artificiale nr. 2003/10
- Ligji i produkteve për mbrojtjen e bimëve nr.03/L-042
- Ligji për mbrojtjen nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare nr. 2010/03-L-104
- Ligji për produktet medicinale dhe pajisjet medicinale nr. 03/L-188
- Ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik nr. 2010/03-L-166
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit nr. 2012/04-L-178.
- Ligji për tregtinë me jashtë nr.04/L048.
- Ligji për pesticidet nr.2003/20
- Ligji për armët, municionin dhe pajisjet përkatëse të sigurisë nr.05L-017
- Ligji për armët nr.05L-022

III.PJESA E TRETË

Institucionet shtetërore përgjegjëse

Departamenti për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike

Departamenti për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike (DKTMS) është i vetmi institucion brenda Qeverisë së Kosovës, i cili ka si fushëveprim kontrollin e tregtisë me mallra strategjike si: importin, eksportin, transitin, trans-ngarkesën, transferimin, ndërmjetësimin për tregti të mallrave me përdorim të dyfishtë, pajisjeve ushtarake dhe shërbimeve të ndërlidhura.

Departamenti kryen këto aktivitete:

Zhvillon analizën dhe bën ekspertizën përkatëse lidhur me tregtimin e mallrave strategjike në të gjitha fazat e procesit, nga faza e regjistrimit në regjistër, deri në kontrollin e mëtejshëm pas pajisjes së subjektit me licencë dhe verifikimin e përdoruesit dhe përdorimit përfundimtar të mallit.

Dokumentet që lëshohen nga Departamenti

CERTIFIKATAT

- Certifikatë për regjistrim në regjistër
- Certificate ndërkombëtare të importit
- Certifikatë për verifikimin e dorëzimit të mallit
- Certifikatë për përdoruesit fundor

LICENCAT

Në Republikën e Kosovës, për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit me mallra strategjike jepen këto **lloje të licencave:**

- Licencë Individuale
- Licencë Globale
- Licencë e Përgjithshme

Sipas aktivitetit jepen këto lloje të licencave:

- Licencë për eksport të mallrave strategjike
- Licencë për ri-eksport, apo ri-transfer të mallrave strategjike
- Licencë për import të mallrave strategjike
- Licencë për brokerët - ndërmjetësuesit
- Licencë për ofrimin e shërbimeve
- Licencë për transit apo trans ngarkim të artikujve strategjike

RAPORTET

- Raporti për mallrat e eksportuara sipas Licencës së Përgjithshme

VENDIMET

- Lëshimi i licencës/autorizimit
- Mos marrja në shqyrtim dhe refuzimi i kërkesës
- Revokimi dhe pezullimi i kërkesës
- Shfuqizimi i licencës.

Komisioni për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike

Komisioni ndërmintor funksionon sipas nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-198 dhe ka këto kompetenca: Shqyrton, aprovon, anulon, ndryshon dhe revokon licencat për eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksportim jashtë territorial, ri-transferim dhe ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura dhe detyra tjera, siç parashihet në këtë ligj dhe aktet nënligjore.

Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë dhe zëvendës-anëtarë, të përfaqësuar nga:

- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (Kryesuese);
- Ministria e Punëve të Jashtme;
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Punëve të Brendshme
- Dogana e Kosovës.

Gjate kësaj periudhe një vjeçare komisioni është thirrur nga kryesuesi 35 here dhe është mbajtur takimi për shqyrtimin e aplikacioneve, si dhe shkëmbimin e informacioneve të ndryshme në lidhje me kontrollin e tregtisë me mallra strategjike.

RREGULLAT

Kontrolli i tregtisë me mallra strategjike, mallra me përdorim të dyfishtë, mallra ushtarake si dhe shërbime të ndërlidhura, është një iniciativë e përbashkët ndërkombëtare, e cila lind si nevojë e mbikëqyrjes së transferimeve ndërkombëtare të mallrave strategjike.

Rregullat ndërkombëtare kryesore në këtë fushë janë:

Rezoluta 1540, e Këshillit të Sigurisë së Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e cila përcakton në mënyrë specifike detyrimin për shtetet anëtare të OKB-së, të marrin masa për kontrollin e transferimit të këtyre mallrave, duke ndërtuar sisteme efikase të kontrollit shtetëror. Rregullorja e Bashkimit Evropian nr. 428/2009, e datës 5 maj 2009, si dhe një sërë pozicionesh dhe veprimesh të përbashkëta, të cilat ndërtojnë një sistem të ndërthurur të kontrollit të lëvizjes së mallrave ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë.

IV.PJESA E KATËRT

Kontrolli dhe licencimi

Kontrolli i tregtisë me mallra strategjike përfshin:

Të gjitha mallrat që përfshihen në listat e kontrollit të Bashkimit Evropian, të cilat miratohen dhe azhurnohen çdo vit me vendim të Qeverisë (aktualisht listat në fuqi janë të miratuara nga Qeveria e Kosovës).

Aktivitetet që i zhvillojnë subjektet që merren me tregti me mallra tregtare strategjike.

- Eksporti
- Importi
- Transiti
- Trans-ngarkimi
- Ndërmjetësimi (brokerimi)
- Shërbimet
- Asistenca teknike.

Objektivat kryesore të kontrollit të tregtisë me mallra strategjike janë:

- Garantimi i certifikatave të regjistrimit në regjistër të licencave, lejeve, certifikatave të përdoruesit të fundit dhe autorizimeve për subjektet (persona fizikë apo juridikë) të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave strategjike, që u jep atyre të drejtën e importit, eksportit, transitit.
- Zhvillimi i negociatave dhe nënshkrimi i marrëveshjeve ekonomike tregtare me jashtë.
- Revokimi i licencave, lejeve dhe certifikatave kur këto subjekte shkelin legjislacionin në fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike.
- Garantimi i dhënies së certifikatave ndërkombëtare të importit dhe certifikatave të përdoruesit të fundit.
- Vlerësimi i kushteve për regjistrimin në regjistër të Departamentit të Kontrollit të Tregtisë me Mallra Strategjike, të subjekteve të cilat kanë për qëllim kryerjen e transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake.

Procedurat e regjistrimit dhe të licencimit

Regjistrimi në regjistër:

Regjistrimi në regjistër rregullohet me Udhëzimin Administrativ nr.02/2016, për regjistrim, licencim dhe zbatimin e procedurave administrative. Subjektet që zhvillojnë aktivitete në tregtinë me mallra strategjike duhet të regjistrohen në DKTMS, i cili iu lëshon këtyre subjekteve një certifikatë regjistrimi dhe mban një regjistër të subjekteve të përfshira në tregtinë ndërkombëtare. Ky është momenti i parë i procesit të licencimit të mirëfilltë.

Aplikimi për t'u pajisur me licencë:

Subjektet tregtare, të cilat dëshirojnë të pajisen me licencë, autorizim apo certifikatë duhet të paraqesin në DKTMS dokumentacionin e kërkuar si dhe të plotësojnë formularin e kërkesës. Kriteret e kërkuara, dokumentacioni përkatës, përgjigjet ndaj pyetjeve më të shpeshta, pikat e informimit për publikun si dhe të gjitha informacionet e nevojshme gjenden të publikuara në web faqen e MTI-së www.mti-ks.org.

Raportimi

Bazuar në pikën 5 të nenit 21 të Ligjit për tregtinë me mallra strategjike, Departamenti përgatit dhe i dërgon Qeverisë versionin e fshehtë të raportit deri më 30 prill të vitit kalendarik, para datës 30 maj të vitit kalendarik Ministria, përkatësisht Departamenti përgatit versionin e raportit për publikim në web faqen e Ministrisë.

Kontrolli dhe licencimi

DKTMS, në bashkëpunim me komisionin, ushtrojnë një kontroll gjithëpërfshirës gjatë procesit të licencimit, i cili shtrihet në gjithë harkun kohor para, gjatë dhe pas momentit të pajisjes së subjektit me dokumentin ligjor specifik.

Objekt i këtij kontrolli janë:

a) Kontrolli i dokumentacionit dhe kërkesës

Ky kontroll konsiston paraprakisht në verifikimin e saktësisë dhe korrektësisë së plotësimit të dokumenteve të paraqitura në përputhje me procedurat ligjore në fuqi si dhe plotësimit në mënyrë korrekte të kërkesës për pajisje me dokument ligjor, që konsiderohet si faza e kontrollit të mirëfilltë të dokumentacionit.

b) Kontrolli teknik i ekspertëve

Kjo fazë kontrolli në fakt i kushtohet verifikimit të mallrave, që janë objekt i licencës, duke bërë krahasimin e të dhënave të përshkruara nga aplikuesi, me ato të mallrave efektive.

Kontrolli i subjekteve rreth pajisjes apo jo me dokumentin e kërkuar sipas ligjit, është i lidhur ngushtë me procesin e vendimmarrjes. Nëse është e nevojshme, për vendimmarrjen bashkëpunohet dhe merren opinionet e organeve tjera të specializuara.

V. PJESA E PESTË

Zhvillimet

Aktivitetet e zhvilluara në periudhën Prill 2018—Prill 2019

KLASIFIKIMI

Gjatë kësaj periudhe kohore DKTMS-ja ka pasur 1003 kërkesa për klasifikim të mallrave strategjike, nga të cilat numër i madhe i tyre ka rezultuar se nuk i nënshtrohen regjimit të kontrollit.

REGJISTRIMI

Aplikimi për regjistrim në regjistra është proces në kontinuitet dhe i paraprinë procesit të licencimit, aktualisht 55 kompani janë regjistruar në regjister të cilat janë të pajisura me certifikata, kompanitë janë në kategorinë e mallrave ushtarake dhe në kategorinë e mallrave me përdorim të dyfishtë.

LICENCIMI

Janë miratuar tridhjeteshtatë (37) licenca individuale që hyjnë tek kategoria e mallrave me përdorim të dyfishtë, ku pesë(5) nga këto janë Re-export, dy(2) Export dhe një (1) që hyjnë te mallrat ushtarake

1. Licencë individuale importi (kategoria ML6a) për kompaninë Mine Action & Training Mondial Kosovo e cila merret me deminim,
2. Licencë individuale importi (kategoria 5A001a, 5D001d) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative,
3. Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a, 5D002.c) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative,
4. Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a, 5D002.c) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative
5. Licencë individuale importi (1A007.a) për kompaninë Mine Action & Training Mondial Kosovo e cila merret me deminim,
6. Licencë individuale importi (kategoria 1C350.45) për kompaninë NPT a-com e cila merret me tregtimin e kimikateve,
7. Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a, 5D002.c) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e

cila merret me teknologji informative

8.Licencë individuale importi (kategoria 5D002.c) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative

9.Licencë individuale importi (5A002) për kompaninë Cactus sh.a e cila merret me pajisje elektronike për kriptimin e të dhënave,

10. Licencë individuale importi (kategoria 1C235, 1C239) për kompaninë Keis Pharmaceutical e cila merret me importimin e medikamenteve,

11.Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a.1, 5D002.c.1) për kompaninë Ipko Telecommunications L.L.C e cila merret me shërbime të telekomunikimit,

12. Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a,) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative

13. Licencë individuale exporti (kategoria 5A002.a,) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative

14. Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a, 5D002.c) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative

15. Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a, 5D002.c) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative

16. Licencë individuale exporti (kategoria 5A002.a,) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative

17 Licencë individuale importi (kategoria 5A002) për kompaninë Cactus sh.a e cila merret me teknologji informative

18. Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a, 5D002.c) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative

19. Licencë individuale importi (kategoria 1C350) për kompaninë NPT a-com e cila merret me tregtimin e kimikateve,

20. Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a) për kompaninë Botek sh.p.k e cila merret me teknologji informative,

21. Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a) për kompaninë Botek sh.p.k e cila merret me teknologji informative,

22. Licencë individuale importi (kategoria 5A002a.1) për kompaninë Cactus sh.a e cila merret me teknologji informative

- 23.** Licencë individuale Re-exporti (kategoria 5A002,5D002) për kompaninë Ericsson Nikola Tesla d.d Branch Office e cila me pajisje elektronike për kriptimin e të dhënave,
- 24.** Licencë individuale Re-exporti (kategoria 5A002,5D002) për kompaninë Ericsson Nikola Tesla d.d Branch Office e cila me pajisje elektronike për kriptimin e të dhënave,
- 25.** Licencë individuale importi (kategoria 5A002,5D002) për kompaninë Ericsson Nikola Tesla d.d Branch Office e cila me pajisje elektronike për kriptimin e të dhënave,
- 26.** Licencë individuale importi (kategoria 5A002,5D002) për kompaninë Ericsson Nikola Tesla d.d Branch Office e cila me pajisje elektronike për kriptimin e të dhënave,
- 27.** Licencë individuale importi (kategoria 5A002,5D002) për kompaninë Ericsson Nikola Tesla d.d Branch Office e cila me pajisje elektronike për kriptimin e të dhënave,
- 28.** Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a, 5D002.c) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative,
- 29.** Licencë individuale importi (kategoria 5A002b) për kompaninë Cactus sh.a e cila merret me teknologji informative,
- 30.** Licencë individuale importi (kategoria 5A002.b, 5A002.a, 5D002.c) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative,
- 31.** Licencë individuale importi (kategoria 5A002.b, 5A002.a,) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative,
- 32.** Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative.
- 33.** Licencë individuale për re-export (kategoria 5A002.a) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k. e cila merret me teknologji informative .
- 34.** Licencë individuale importi (kategoria 5A002.a) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k e cila merret me teknologji informative.
- 35.** Licencë individuale për re-export (kategoria 5A002.a) për kompaninë Asseco SEE Sh.p.k. e cila merret me teknologji informative .
- 36.** Licencë individuale për re-export (kategoria 5A002.A) për kompaninë Ipko Telecommunications L.L.C e cila merret me shërbime të telekomunikimit,
- 37.** Licencë individuale për import (kategoria 5A002.A) për kompaninë Mrezne Tehnologji Verso d.o.o Branch in Kosovo e cila merret me teknologji informative.

Aktivitetet tjera

-Me 19 Prill 2018 është mbajtur konferenca vjetore për industrinë , e cila u organizua nga Departamenti i kontrollit të tregut me mallra strategjike nën asistencën dhe financimin e plotë të programit EXBS të Ambasadës së SHBA-ve në Prishtinë. Te pranishëm ishin 32 kompanitë të cilat merren me mallra strategjike, institucionet përgjegjëse të përfshira në procesin e kontrollit strategjik, si dhe ekspertet e jashtëm të mbështetur nga EXBS .



-Pjesëmarrja e ekspertit kroat i kontraktuar nga EXBS- ardhja e ti katër (4) herë gjatë këtij viti me qëndrim nga dy javë në zyrat e DKTMS-së.



Vendimet tjera;

1)Plotësim ndryshimi i vendimit te Qeverise për Komisionin e Licencimit NR.16/61 i datës 22.08.2018

2)Plotësim ndryshimi i vendimit te Qeverise për Komisionin e Licencimit NR.04/90 i datës19.02.2019

3)Vendimi nr. 02/29 i datës 01.03.2019

Miratimi i Planit te Brendshëm te Pajtueshmërisë, si dhe aprovimi i pesë udhëzuesve :

a).Udhëzues për pranimin, shqyrtimin dhe marrjen e vendimit në lidhje me kërkesat për licence për tregti strategjike.

b).Udhëzimet për udhëheqjen e informimit publik.

c).Udhëzimet për promovimin e krijimit, certifikimit dhe auditimit të programeve të brendshme te pajtueshmërisë.

d).Udhëzime për kryerjen e veprimeve zbatuese administrative.

e).Udhëzuesit për komisionin për kontrollin dhe licencimin e mallrave strategjike.

Pjesmarrja në punëtori , seminare ,trajnime;

Muaji	Aktiviteti	Realizimi
Maj	Vizite studimore organizuar nga organizata BAFA lidhur me COARM - Vienna, Austria	16.05.2018 – 17.05 2018
Prill	Pjesëmarrje ne Konsultimet mbi zbatimin administrativ te kontrollit strategjik te tregtisë -Prishtine, Kosovë	23.04.2018-25.04.2018
Qershor	Pjesëmarrje ne takim me Joe Baldwin dhe Dave Froman, teme e diskutimit ishte “Plani i Propozuar për Ballkanin. Prishtine-Kosove	13.06.2018
Shtator	Pjesëmarrja ne grupin punues për hartimin e strategjisë kundër mos përhapjes se armeve te shkatërrimit ne mase(WMD) Racviac-Zagreb	16.09.2018-20.09.2018
Shtator	Trajnim për Departamentin dhe Komisionin me ekspertët e projektit BAFA ne lidhje me klasifikimin e produkteve me perdorim te dyfishte dhe ato ushtarake	25.09.2018-26.09.2018
Shtator	Trajnim për Departamentin dhe Komisionin/Doganat - me ekspertët e programit Amerikan EXBS lidhur me krijimin e web-faqes se Departamentit, Planin e Brendshëm te Pajtueshmërisë dhe klasifikimin e mallrave strategjike.	27.09.2018-28.09.2018

Shtator	Pjesëmarrje ne trajnimin e radhës ne Racviac: Dokumenti i Vjenës – Kursi i Verifikimit dhe Pajtueshmërisë	01.10.2018-05.10.2018
Tetor	Pjesëmarrje dhe prezantim nga DKTMS para vendeve te rajonit nga fusha e kontrollit te exporteve ne “Workshopin regjional për exportin e armeve”. Tiranë	09.12.2018-12.10.2018
Tetor	Pjesëmarrje ne takimin “Dialogu i dytë mbi zhvillimin e kontrollit të exportit”. Bruksel	03.10.2018-06.10.2018
Tetor	Pjesëmarrje ne “Akademia e Menaxhimit te Tregtisë te Sigurisë dhe Strategjisë “Universiteti i Gjeorgjisë-SHBA	13.10.2018-28.10.2018
Shkurt	Pjesëmarrje ne workshop-in regjional për zbatimin e Kontrollit të Mallrave Strategjike, organizuar nga ambasada Amerikane projekti EXBS- Tiranë	04.02.2019-07.02.2019
Shkurt	Pjesëmarrje ne inspektimin e kompanisë “Ericsson Nikola Tesla d.o.o Branch Kosovo”	26.02.2019
Shkurt	Pjesëmarrje ne inspektimin e kompanisë “Ipko Telecomunacions”	28.02.2019
Mars	Pjesëmarrja në punëtorin VITAL SHIELD-TTX e organizuar nga EUCOM dhe RACVIAC –e mbajtur në Prishtinë	18-03.2019-20.03.2019
Prill	Pjesëmarrja ne punëtorin “Wisconsin Project’s Risk Report database” e organizuar nga ana e EXBS-it e mbajtur në Tiranë	08.04.2019-09.04.2019

Të Tjera;

Hartimi i plani vjetor i veprimit për përmirësimin e kontrollit strategjikë për vitin 2019 i cili përmbanë;

Planin e inspektimeve

Mbajtja e punëtorive vetëdijësuese për industrinë e bizneseve

Bashkëpunimi me Institucionet e përfshira në procesin e kontrollit startegjikë

Plani i kontrolleve në pikë kalimet doganore së bashku me zyrtarët nga Dogana e Kosovës

Identifikimi i kompanive të reja potenciale për tregtim me mallra startegjike.

VI. PJESA E GJASHTË

Bashkëpunimet

Bashkëpunimi me Industrinë

Janë organizuar dhe mbajtur 6 punëtori (takime informuese) me biznese për tu informuar rreth procedurave të regjistrimit në regjistra, procedurave të klasifikimit të mallrave strategjike si dhe procedurave të licencimit.

Pjesëmarrëse në këto punëtori ishin 60 biznese të cilat merren me teknologji informative, pajisje dhe produkte medicinale, përpunimi i materialeve dhe kemikateve të ndryshme, armë dhe municion, pajisje ushtarake, shërbime të ndërlidhura, ndërmjetësime etj.

Kompanitë pjesëmarrëse janë informuar për obligimet nga Ligji 198 për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike dhe janë pajisur me dokumentacionin e nevojshëm.

Gjatë takimeve ka pasur diskutime të shumta e kryesisht fokusi ishte tek identifikimi dhe klasifikimi i mallrave e cila është si pika më sfiduese e tërë këtij procesi.

Pas pjesëmarrjes në këto takime informuese bizneset kanë ardhur në departament për tu ndihmuar nga zyrtarët rreth klasifikimit dhe identifikimit të mallrave të cilat ata i tregtojnë. Disa nga këto kompani pjesëmarrëse janë vizituar edhe nga ana e zyrtarëve të departamentit për tu njoftuar për së afërmi me veprimtarit që i zhvillojnë e njëkohësisht edhe për të bërë identifikimin e pajisjeve dhe makinerive të cilat i shfrytëzojnë këto kompani për të kuptuar dhe informuar se këto pajisje a mund të modifikohen për qëllime tjera prodhuese.

Identifikimi i bizneseve që zhvillojnë aktivitete biznesi me mallra strategjike.

Janë identifikuar biznese që konsiderohet se zhvillojnë aktivitete në tregtimin, ndërmjetësimin apo ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura me mallra strategjike. Kemi kontaktuar kompanitë jemi takuar me ta individualisht, shumë nga këto kompani kanë marr pjesë në takimet informuese të realizuara nga departamenti ku janë njoftuar rreth procedurave të regjistrimit në regjistra dhe të licencimit i kemi pajisur me të gjitha materialet e nevojshme informuese (ligjin, udhëzimet administrative, kriteret e aplikimit, lista e mallrave ushtarake, lista e mallrave me përdorim të dyfishtë etj). Vazhdimisht është punuar në identifikimin e kompanive të reja që hyjnë në këtë kategorinë e mallrave strategjike gjithnjë duke bashkëpunuar me institucionet e ndryshme dhe asociacionet e bizneseve, odat ekonomike etj.

Në identifikimin e këtyre kompanive bëjnë pjesë kompani të cilat merren me:

- a) pajisje dhe produkte medicinale,
- b) teknologji informative,

- c) përpunimi i materialeve dhe kemikateve të ndryshme,
- d) armë dhe municion,
- e) pajisje të ndryshme ushtarake,
- f) shërbime ndërmjetësuese, përpunimi dhe prodhimi i metaleve etj.

Bashkëpunimi me Institucionet

Janë mbajtur takime të kohëpaskohshme me përfaqësuesit e Doganës lidhur me identifikimin e kompanive të cilat merren me mallra strategjike. Nga Dogana janë marr informata të sakta rreth shkëmbimeve tregtare të cilat i kanë realizuar kompanitë ku janë identifikuar ato që merren me mallra strategjike në bazë të analizave dhe hulumtimeve të dokumenteve dhe kontrolleve fizike të transfereve tregtare.

Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme si: MPB, MPJ, MM, DOGANA, AKMRRSB, AKPM, MMPH, MSH etj. Qëllimi i këtij bashkëpunimi ka qenë i fokusuar në zbatimin e legjislacionit për kontrollin e tregtisë me mallrat strategjike e që ndërlidhen me Ligjin për armët, Ligji për mbrojtjen nga rrezatimi, Ligji për sanksionet, Ligji për materialet shpërthyes, Ligji për produktet dhe pajisjet medicinale etj. si dhe marrja e informacioneve rreth kompanive që zhvillojnë veprimtari që hyjnë në kategorinë e mallrave strategjike e të cilat kanë marrëdhënie kontraktuale me institucionet dhe lejet e licencat e lëshuara nga këto institucione për kompanitë që ndërlidhen me këtë fushë.

Bashkëpunimi me vendet e regjionit

Është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit me Ministrinë e Ekonomisë të Malit të Zi respektivisht me zyrën homologe të kontrollit të mallrave strategjike. Të gjitha procedurat janë kryer përmes zyrës ligjore dhe MPJ-së Kosovë në harmoni me MPJ-në e Malit të Zi .

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është bashkëpunimi në fushën e kontrollit të mallrave ushtarake, mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, shkëmbimin e informacioneve dhe eksperiencave lidhur me çështjet e kontrollit dhe transferimeve ndërkombëtare të mallrave strategjike dhe mospërhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshjeje pritët shkëmbimi i informacioneve lidhur me kërkesat e adresuara nga palët nënshkruese rreth eksporteve për disa kompani që tregtojnë mallra strategjike.



Bashkëpunimi me donatorët

Sa i përket bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare vlen të theksohet bashkëpunimi me Ambasadën Amerikane përmes programit EXBS (Export Control and Related Border Security).

Ky program është përkrahësi dhe mbështetësi kryesor sa i përket kontrollit të tregut strategjik me ç' rast kanë ofruar edhe një numër të konsiderueshëm trajnimesh dhe seminaresh në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të DKTMS-së, bashkëpunimi dhe përkrahja përmes angazhimit të ekspertëve të tyre në hartimin e ;

-Udhëzimi Administrativ nr.14/2013 për rexhistrimin,licencimin dhe zbatimin e procedurave administrative.

-Udhëzimi Administrativ nr.02/2016 për formularin e regjistrimit ,të licencimit, klasifikimit dhe certifikimit të tregtisë me mallra strategjike dhe shërbimeve të ndërlidhura;

-Rregullore nr.35/2013 për funksionimin e punës së komisionit për kontrollin e tregtisë me mallra startegjike.

-Programin e brendshëm të pajtueshmëris

-Udhëzimi për klasifikim të mallrave;

-Udhëzues për pranimin, shqyrtimin dhe marrjen e vendimit në lidhje me kërkesat për licencë për tregti strategjike;

-Udhëzues për marrjen e vendimeve lidhur me kërkesat për licencim;

-Udhëzimet për udhëheqjen e informimit publik;

-Udhëzimet për promovimin e krijimit,certifikimit dhe auditimit të programeve të brendshme të pajtueshmërisë

-Udhëzimet për kryerjen e veprimeve zbatuese administrative

Përkrahjen me paisje pune për zyre si; kompjuterë, llaptop, aparate ,camera, telefona, projektorë, printera, router, usb etj.

Poashtu vlen te theksohet se i është dhuruar departamentit një makine e re për nevoja të inspektimit ne teren si dhe vizita studimore ne vendet e regjionit.



Përkrahja në përgatitjen e specifikave teknike rreth data bazës për mallrat strategjike, sigurimin dhe financimin e përkthimeve të listës me mallra ushtarake dhe listës me mallra për përdorim të dyfishtë, këshilldhënia nga ana e eksperteve të tyre me kërkesë të departamentit dhe komisionit ndërministror, siguri i informatave rreth Konventave, Traktateve e Rezolutave të ndryshme sa i përket kontrollit strategjik në të cilat Kosova nuk është e anëtarësuar etj.

Bashkëpunimi me Zyrën Federale Gjermane për çështjet ekonomike dhe të kontrollit të eksportit BAFA, të cilët kanë përkrahur departamentin me ofrimin e trajnimeve dhe seminareve në ngritjen e kapaciteteve në fushën e kontrollit strategjik etj.

Bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtare, autoritetet homologe në rajon

Në këtë periudhë kohore, Departamenti ka pasur një bashkëpunim të frytshëm me disa institucione tjera ndërkombëtare dhe homologe në rajon si:

Zyrën e Kontrollit të Eksporteve dhe Sigurisë së Kufijve (EXBS, Export Control and Border Security) EXBS

Bashkëpunimi me Kroacinë (Departamenti për armë dhe leje pranë Ministrisë së Financave si dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Integrimeve Evropiane)

RACVIAC- Qendra për Siguri dhe Bashkëpunim, me seli në Zagreb-Kroaci.

Autoritetin e Kontrollit të Eksporteve Shqiptare-Tiranë.

Departamentin për Politikë dhe Regjim të Tregtisë së Jashtme – Ministria e Ekonomisë, Podgoricë, Mal të Zi.

Zyra e Federale Gjermane për çështje ekonomike dhe kontroll të eksportit (BAFA).

VII. PJESA E SHTATË

Sanksionet

Për një shkelje, e cila ka shkaktuar dëme ose pasoja të rënda për sigurinë shtetërore, politikën e jashtme ose sigurinë publike, kryesit mund të dënohen nga 1 deri 8 vjet burgim ose me gjobë nga 10.000 € (dhjetë mijë euro) deri në 30.000 € (tridhjetë mijë euro). Në raste të veçanta mund të dënohen edhe me vlerë 4 herë më të madhe sesa vlera e mallit.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, përkatësisht DKTMS mund të shqiptojë edhe masa tjera administrative, si të licencës apo regjistrimit ose të shqiptojë gjoba nga 1000 € (një mijë euro) deri në 5000 € (pesë mijë euro), ose dyfishin e vlerës së mallit.

VIII. PJESA E TETË

Sfidat dhe Rekomandimet

Sfidat

- Eksperienca e mangët e institucioneve të Kosovës, në fushën e kontrollit strategjik të tregut.
- Stafi i pamjaftueshëm ,mungesa e profileve specifike për t'i realizuar objektivat e parapara me planin e punës.
- Shmangia e bizneseve për t'ju nënshtruar regjimit te licencave.
- Mungesa e mjeteve financiare buxheti shume i vogël i Departamentit për promovimin e proceseve dhe ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët e institucioneve përfshirëse në këtë proces.

Rekomandimet aktuale të DKTMS-së janë:

- Rritja e buxhetit të Departamentit ,
- Rritja e numrit me staf profesional .

Për përmirësime të mëtejme në fushën e kontrollit të tregtisë me mallra strategjike nevojitet:

Plotësimi i angazhimeve ndërkombëtare të Republikës së Kosovës, që vijnë nga Rezoluta 1540 e OKB-së, rekomandimeve dhe dokumenteve të tjera lidhur me parandalimin e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe luftës ndaj terrorizmit.

Fillimi i procedurave për anëtarësimin e Kosovës në traktatet ndërkombëtare dhe regjimet e kontrollit si në: Marrëveshjen e Wassenarit (WA), Grupin e Australisë (AG), Regjimin e Kontrollit të Teknologjisë së Raketave (MTCR), Grupin e Furnizuesve Bërthamorë (NSG), dhe Komitetin Zangger (ZC).

Krijimi i një bashkëpunimi rajonal sa më efektiv në fushën e kontrollit të eksporteve.

Pjesëmarrja në EU Cooperation under the Long term project (LTP).

Realizimi i Data bazës për nevoja të Departamentit dhe komisionit, e cila pritët që gjatë vitit 2019 te funksionalizohet – data bazë kjo e cila pritët te dhurohet donacion nga programi i EXBS-it

Prill 2019